



Muhammed ibn Salih el-Uthejmin

F R Y T E T E T A K V A S È

AL HIDAAYAH PUBLISHING AND
DISTRIBUTION

Frytet e Takvasë

Sheikh Muhammed ibn
Salih el Uthejmin

Titulli:

Frytet e takvasë

Autor:

Muhammed ibn Salih el Uthejmin

Përkthyes:

Ebu Enisah Ilir Delija

Botues:

**Al Hidaayah Publishing and
Distribution**

Te gjitha falenderimet i takojne Allahut, Zotit te boterave. Paqja dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin, familjen e tij, sahabet e tij dhe te gjithe ata qe e ndjekin ate deri ne diten e kijametit. O vellezer ne iman! Me te vertete keshilla qe Allahu u ka dhene roberve te Tij qe nga koha e Ademit, alejhi selam, e deri tani, eshte qe ta kene frike Ate, i madheruar e i lartesuar qofte Ai. I Plotefuqishmi, i Madheruari, thote:

"Ne u patem sugjeruar atyre qe u ishte dhene libri para jush e edhe juve, qe te keni frike All-llahun. Po ne mos besofshit, (dijeni) e All-llahut eshte ç'ka ne qiej e ç'ka ka ne toke. All-llahu eshte i panevoje e i falenderuar". (Nisaa, 4:131)

Dhe, eshte edhe keshilla e te Derguarit te Allahut, salAllahu

alejhi ue selem, ndaj ummetit te tij:
Ebi Umaamah Suddi Ibn Uxhlaan el
Baahili, radiAllahu anhu,
transmeton:"E degjova te Derguarin
e Allahut, salaAllahu alejhi ue
selem, duke thene nje fjalim ne
Haxhin e lamtumires:"Kini frike
Zotin tuaj, kryeni namazin ne 5
kohet, agjeroni muajin e Ramadanit,
jepni Zekatin, dhe bindjuni
udheheqesve tuaj. Duke bere kete,
do te hyni ne xhennetin e Zotit
tuaj." (Transmeton Tirmidhi)

Sa here qe i Derguari i Allahut,
salAllahu alejhi ue selem, dergonte
prijesin e nje beteje, e keshillonte
ate qe te kishte *takua* te thelle dhe e
keshillonte edhe ushtrine me kete.
Te paret tane te mire nuk ndaluan
ndaluan ne keshillimin e njeri-tjetrit
per takua ndaj Allahut ne fjalimet e
tyre, ne letrat e tyre dhe ne
testamentet e tyre pas te Derguarit

te Allahut, salAllahu alejhi ue selem. Umer ibnul Khattab i shkruajti djalit te tij, Abdullahit:"Duke vazhduar:"Te keshilloj te kesh frike Allahun, te Plotefuqishmin, te Madheruarin, se kush e ka frike Ate, Allahu do ta ruaje; kushdo qe i jep hua Allahut, Allahu do ta shperbleje; dhe kushdo qe e falenderon Allahun, Allahu do t'ia shtoje atij (te mirat)."

Ali, radiAllahu anhu, i dha nje keshille nje njeriu:"Te keshilloj te kesh frike Allahun, te Plotefuqishmin, te Madheruarin. Nuk mund t'i shmangesh takimit me Te. Dhe askush nuk do te takoje ty perveç Atij kur te arrish akhiretin, se me te vertete Allahu eshte pronari i kesaj bote dhe tjetres."

Nje nga te devotshmit, i shkruajti vellait te tij ne besim:"Te keshilloj te kesh frike Allahun, i Cili i di

sekretet e tua dhe i sheh veprat e tua. Keshtu qe permende Allahun ne çdo kohe gjate nates e dites, dhe ki frike Allahun ne baze te te qenit te Tij afer teje (me dijen, pushtetin, shikimin, degjimin, planifikimin e Tij) dhe per Fuqine qe Ai ka mbi ty. Dhe ta dish se Ai perhere te sheh ty. Dhe, mos e le Gjykimin e Tij per nje Gjykim tjeter dhe as Pushtetin e Tij per ndonje pushtet tjeter. Por lartesoje Ate, dhe frikesoju Atij."

Kuptimi i *takuas* eshte qe nje rob te vendose ne mes vetes dhe asaj qe ia ka friken nje roje qe do ta mbroje ate." (Ibn Rexhebi tha:"Esenca e *takuas* eshte te vendosesh nje mburoje qe te ruan nga zemerimi i Allahut dhe denimi i Tij. Ajo mburoje eshte qe t'i bindesh urdherave te Tij dhe te largohesh nga ndalimet e Tij". (Xhami Ulum uel Hikam 190/191))

Kuptimi i *takuas* ne lidhje me roberit e Allahut, eshte qe robi te vendose ne mes te tij dhe asaj qe ia ka friken ~ psh ta zeje denimi dhe zemerimi i Allahut ~ nje roje qe e mbron ate. Duke iu bindur Atij e duke i qendruar larg mosbindjes.

Vellai im fisnik, ketu jane disa thenie te selefus-salih, qe sqarojne kuptimin e *takuas*. Ibn Abbasi, radiAllahu anhu, tha:"Ata qe kane frike Allahun, jane ata qe mbrohen prej denimit te Allahut."

Tabi'ini, Talk ibn Habib, tha:"Nese vjen diçka ne mes jush, atehere shuajeni me *takua*. Ku u pyet se çfare eshte *takua*, ai u per gjigj:"*Takua* eshte qe te veprosh ne bindje ndaj Allahut, duke shpresuar ne meshiren e Tij prej nje drite prej Tij, dhe *takua* eshte qe t'i lesh veprat e mosbindjes duke e patur frike Allahun prej nje drite

prej Tij."

Ibn Mes'ud, radiAllahu anhu, tha:"Duke folu per thenien e Allahut:"O ju qe keni besuar, kini frike Allahun me nje frike te vertete e mos vdisni vecse si muslimane" (Ali Imran, 102), se Allahut duhet t'i bindesh dhe jo ta kundershtosh; duhet ta perkujtosh gjate gjithe kohes, dhe mos ta harrosh; dhe ta falenderosh, e jo te jesh mosfalenderues."

Keshtu, vellai im, mundohu te kesh frike Allahun, te Plotefuqishmin, te Madheruarin, sepse Ate, i lavderuar qofte, duhet ta kesh frike, ta lartesosh dhe ta nderosh e respektosh ne zemren tende. Ketu jane disa ka perfitimet e qarta, nese e ke frike Allahun ne kete bote:

Frika ndaj Allahut ben qe te te lehtesohen punet.

"E kush i frikesohet All-Ilahut, Ai atij ia lehteson punen." (Talak, 4)

"E sa i perket atij qe jep dhe ruhet, dhe verteton bindshem per me te miren, Ne do ta pergatisim ate per me te lehten." (Lejl, 5-7)

Takua e ruan njeriun nga demtimi i shejtanit.

"Vertet, ata qe jane te ruajtur, kur i prek ndonje iluzion nga djalli, ata perkujtojne (All-Ilahun), dhe atehere shohin (te verteten)". (A'raf, 201)

Me te vertete *takua* eshte shkak i hapjes se miresise nga qielli e toka.

"E sikur njerez e qytetit te kishin besuar e te kishin takua, do te hapnim per ta miresite nga qielli e toka." (A'raf, 96)

Takua ben qe robi te jeti i suksesshem ne dallimin e te vertetes nga e kota, dhe te kete dijeni rrerh tyre.

"O ju qe keni besuar, nese e keni frike Allahun, Ai do t'ju jape nje *furkan* (dallues ne mes te vertetes e te kotes)..." (Enfal, 29) (el Hafidh ibn Kethir tha:"Ibn Abbas, es-Suddi, Ikrimah, ed-Dahhak, Katadeh dhe Mukatil, te gjithe thane se Furkan ka kuptimin: nje rrugezgjidhje nga çdo veshtiresi. Muxhahid shtoi:"Nje rrugezgjidhje nga çdo veshtiresi ne kete bote e ne boten tjeter. Ne nje transmetim nga Ibn Abbasi qe ka thene se kjo ka kuptimin e shpetimit, dhe ne nje transmetim tjeter prej tij, qe ka kuptimin e ndihmes.

Muhammed ibn Is'hak tha qe ka kuptimin e ka dallim ne mes te vertetes e se kotes. Ky shpjegim i Ibn

Is'hakut eshte me i per gjithshem se ato te meparshmet. Sepse, kush e ka frike Allahun, duke iu bindur urdherave te Tij dhe duke u larguar nga ndalimet e Tij, do t'i jepet mundesia te dalloje ne mes te se vertetes e se kotes. Dhe, kjo do te jete nje shkak qe ai te jete i shpetuar, i ndihmuar, dhe do te beje qe t'i lehtesohen punet ne dunja dhe te jete i lumtur ne akhiret. Dhe, do te beje qe t'i falen mekatet prej Allahut, dhe te fitoje faljen e Allahut dhe te mbrohet prej njerezve. Dhe, do te behet qe te fitoje nje shperblim te madh ashtu siç Allahu ka thene:

"O ju qe keni besuar, kini frike All-lahun dhe vazhdoni me besim ndaj te derguarit te Tij, se Ai ju jep dyfish nga meshira e Tij, ju dhuron drite qe ecni me te, ju fal mekatet tuaja; All-lahu eshte Mekatfales, Meshirues." (Hadid, 28)

Nese nje besimtar eshte ne veshtiresi dhe ai ka *takua*, kjo ia mundeson atij qe te dale nga ajo dhe te perfitoje furnizim dhe lehtesim nga Allahu, ne menyre te atille qe ai kurre nuk e kishte menduar.

"Keshtu keshillohet ai qe i beson All-llahut dhe dites se fundit, e kush iu permbahet dispozitave te All-llahut, atij Ai i hap rruge dhe e furnizon ate prej nga nuk kujton fare." (Talak, 2-3)

Me te vertete eshte shkak i fitimit te mbrojtesve te fese se Allahut. Sepse, mbrojtesit e fese se Allahut jane ata qe e kane frike Ate.

"Kujdestaret e saj jane vetem ata qe ruhen (te devotshmit)..." (Enfal, 34)

"Ata nuk mund te mbrojne ty per asgne te All-llahu. Zullumqaret jane miq te njerit- tjetrit, kurse All-llahu eshte mbrojtes i te devotshmeve." (Xhathijah,19)

Takua ia mundeson besimtarit qe te mos kete frike demin e pabesimtareve dhe planet e tyre.

"Po ne qofte se ju beheni te durueshem dhe ruheni (mekateve), dinakeria e tyre nuk do t'ju demtoje aspak. Eshte e sigurt se All-llahu e ka ne dore ate qe punojne ata." (Ali Imran, 20)

Eshte edhe arsyja qe Allahu dergon ndihme prej qiellit ne kohe veshtiresie kur ka ndeshje me armiqte e Allahut.

"All-llahu ju ndihmoi juve ne Bedr kur ju ishit pak ne numer, e per te qene mirënjos, keni frike nga Zoti. Kur ti u thoshe

besintareve: A nuk eshte mjaft per ju qe Zoti juaj t'ju vazhdoje ndihmen me tre mijë engjejve e zbritur? Po nese jeni te qendrushem e te matur, e ata (armiqte) t'ju vine tash ne kete moment, Zoti juaj jua vazhdon ndihmen me pese mijë engjej te ushtruar (per lufte) ose te shenuar... E ate (ndihme) All-llahu nuk e beri per tjeter por vetem per t'ju gezuar dhe per te qetesuar zemrat tuaja me te, perndryshe ndihma vjen vetem prej All-llahut, ngadhenjyesit, te urtit." (Ali Imran, 123- 126)

Ardhja e ndihmes eshte nje lajm i mire per besimtarin, nje siguri per zemren dhe nje ndihme prej me te fuqishmit me te dijshmit.

"E ate (ndihme) All-llahu nuk e beri per tjeter por vetem per t'ju gezuar dhe per te qetesuar zemrat tuaja me te, perndryshe ndihma

vjen vetem prej All-llahut, ngadhenjyesit, te urtit." (Ali Imran, 126)

Takua ben qe te shuhet armiqesia ne mes te roberve te Allahut.

"Ndihmohuni mes vete me te mira dhe ne te mbara, e mosni ne mekate e armiqesi. Kini dro denimin e All-llahut, se me te vertete All-llahu eshte ndeshkues i forte." (Maide, 2)

"Ajo vuri nje perde ndaj tyre. Ne ia derguam asaj Xhibrilin, e ai iu paraqit asaj njeri ne teresi. Ajo tha: "Une i mbeshtetem te Gjithemeshireshmit prej teje, nese je qe i frikesohesh Atij." (Merjem, 17-18)

Takua e ben besimtarin qe t'i nderoje shenjat e Allahut.

"Kjo eshte keshtu! E kush madheron dispozitat e All-llahut,

ajo eshte shenje e devotshmerise se zemrave." (Haxh, 32)

Eshte shkak qe besimtari kryen vepra te mira, nje shkak qe te pranohen prej Allahut, dhe eshte falje e mekateve.

"O ju besimtare, pembajuni mesimeve te All-llahut dhe thuani fjale te drejta. Ai (All- llahu) ju mundeson te beni vepra te mira dhe ju shlyen juve mekatet tuaja. E kush respekton All-llahun dhe te derguarin e Tij, ai ka arritur nje sukses te madh." (Ahzab, 70~71)

Takua e ben nje besimtar qe ta ule zerin e tij perpara te derguarit te Allahut, salAllahu alejhi ue selem, qofte kjo gjate jetes apo kur nderroi jete.

"Ata qe ulin zerat e tyre prane te derguarit te All-llahut, All-llahu zemrat e tyre i ka pershtatur per

devotshmeri. Ata kane falje mekatesh dhe shperblim te madh." (Huxhurat, 3)

Dijetaret kane thene:"Eshte e papelqyeshme qe ta ngresh zerin kur je tek varri i Profetit, salAllahu alejhi ue selem, ashtu siç ishte e papelqyeshme qe te ngrihej zeri ne prani te tij kur ai ishte gjalle. Keshtu, ashtu siç e respektojme kur ishte gjalle, ashtu e respektojme kur eshte i vdekur.

Takua ben qe besmitari te fitoje dashurine e Allahut, dhe kjo eshte dashuri qe Allahu ia jep besimtarit ne kete jete dhe ne tjetren.

I Derguari i Allahut, salAllahu alejhi ue selem, tha se Allahu thote:"Nuk ka rruge me te mire per robin qe te me afrohet Mua sesa me gjerat qe une ia kam bere atij te detyrueshme. Dhe roberit qe bejne

vepra vullnetare me afrohen Mua derisa Une t'i dua ata; dhe nese Une i dua ata, Une behem degjimi me te cilin ai degjon, shikim me te cilin ai shikon, dora me te cilen ai kap, kemba me te cilen ai ecen. Dhe, nese ai me kerkon Mua, do t'i jap; nese kerkon Mbrojtjen Time, do ta mbroj." (Bukhari)

"Po kush e perm bush emanetin e vet (eshte besnik) dhe ruhet nga mekatet, s'ka dyshim, All-llahu i do ata qe ruhen." (Ali Imran, 76)

Takua ben qe robi te fitoje dituri dhe eshte çelesi i diturise.

"Kini frike All-llahun, se All-llahu ju dhuron dituri (te jashtezakonshme), All-llahu eshte i Gjithdijshem per çdo send." (Bekare, 282)

Takua ben qe besimtari te behet i forte. Nje njeri qe ka *takua* do te jetë i ruajtur nga devijimet, dhe do te qendroje ne rruge te drejte.

"Dhe se kjo eshte rruga (feja) Ime e drejte (qe e caktova per ju). Pra permbajuni kesaj, e mos ndiqni rruge te tjera qe do t'ju ndajne nga rruga e Tij. Keto jane porosite e Tij per ju, ashtu qe te ruheni". (En'am, 153)

Me te vertete *takua* ben qe besmitari te fitoje meshiren Allahut ne kete jete e ne jeten tjeter.

"(Zoti) tha: "Denimi im eshte ai me te cilin e godas cilin dua, e meshira Ime ka perfshire secilin send. Ate (Meshiren) do ta caktoj per ata te cilet i ruhen (mekateve), e jepin zeqatin dhe per ata qe argumentet tona i besojne". (A'raf,

Takua ben qe besimtari te fitoje shoqerimin e Allahut, dhe kjo eshte dy llojesh:

Lloji i pare eshte i per gjithshem per te gjithe roberit e Tij, kur Allahu i shoqeron ata me Degjimin, Shikimin dhe Diturine e Tij. Se me te vertete Allahu, me i larti, eshte Ai qe degjon gjithcka, qe shikon dhe di çdo gje te roberve dhe gjendjet e tyre.

"E Ai eshte me ju kudo qe te jeni."
(Hadid, 4)

"A nuk e di ti (o degjues) se Allahu di ç'ka ne qiej dhe ç'ka ne toke?! Nuk behet bisede e fshehte mes tre vetave e te mos jete Ai i katerti; e as mes pese vetave e te mos jete Ai i gjashti, e as mes pak vetave dhe as ne shume vetave, e te mos jete Ai me ta, kudo qe te jene.

Pastaj, ne diten e kijametit i njofton ata me ate qe kane punuar. All-Ilahu ka perfshire çdo send ne dijen e vet."(Muxhadele, 7)

Sa per llojin e dyte, ai eshte i veçante dhe ka te beje me ndihmen dhe mbrojtjen e Allahut.

"Mos u frikeso, se Allahu eshte me ne."(Teube, 40)

"(Ai) Allahu tha:" Mos kini frike se une jam me ju, Degjoj e Shikoj." (Ta Ha, 46) E nuk ka dyshim se lloji i veçante i shoqerimit eshte per ata qe kane frike Allahun.

"S'ka dyshim se All-Ilahu eshte me ata qe jane te devotshem (qe ruhen prej te keqijave) dhe me ata qe jane bamires."(Nahl, 128)

"E ta dish se Allahu eshte me muttekinet."(Teube, 36)

Ata do te kene nje mbarim te mire ne diten e gjykimit, per shkak se e kishin frike Allahun.

"Perfundimi i mire eshte per muttekunet." (Ta Ha, 132)

"Me te vertete per ata qe kishin frike eshte perfundimi i mire." (Saad, 49)

"Bej durim! Se perfundimi i mire eshte per ata qe kane frike Allahun (muttekun)." (Hud, 49)

Me te vertete (*takua*) ben qe besimtari te kete lajme te gezueshme ne kete jete, duke pare ndonje enderr ose prej dashurise e lavderimit qe njerezit kane per te.

"Ata qe besuan dhe kishin frike, per ata jane lajmet e gezueshme ne kete bote e ne boten tjeter." (Junus, 63-64)

Imam Ahmed transmeton prej Ebu Derdas, radiAllahu anhu, se Profeti, salAllahu alejhi ue selem, tha ne lidhje me thenien e Allahut:"Per ata jane lajmet e gezueshme", eshte nje enderr e mire, qe nje musliman sheh ose qe e sheh dikush tjeter per te". (Muslim)

Ebu Umer el Gifari, radiAllahu anhu, transmeton se ai e pyeti Profetin, salAllahu alejhi ue selem:"O i derguari i Allahut, si eshte puna me njeriun qe ben vepra e njerezit e lavderojne dhe e vleresojne? Profeti tha:"Ky eshte nje lajm i mire ne kete bote per besimtarin." (Muslimi)

Takua e ndalon gruan qe te flase me ze te bute, dhe keshtu e ndalon ate burre qeka semundje ne zemer.

"O grate e Pejgamberit, ju nuk jeni si asnje grua tjeter, nese keni kujdes e ruheni. Andaj, mos u llastoni ne te folur e te lakmoje ai qe ka semundje ne zemren e tij, po thoni fjale te matura." (Ahzab, 32)

Me te vertete *takua* e ndalon padrejtesine ne lidhje me pasurine.

"Kur ndonjerit prej jush i eshte afruar vdekja, nese le pasuri pas vete, testamenti (vasijeti) per prinderit dhe per te afermit eshte obligim, ashtu siç eshte drejte. Per ata qe jane te devotshem, kjo eshte detyre qe duhet kryer." (Bekare, 180)

Takua ben qe besimtari t'i jape gruas se divorcuar ate qe i takon.

"Per te devotshmit eshte obligim qe edhe per grate e leshuara te bejne nje furnizim te zakonshem." (Bekare, 241)

Me te vertete shkakton qe besimtari mos ta humbe shperblimin e veprave te mira ne kete bote e ne boten tjeter. Allahu thote, pasi qe i ka dhene Jusufit miresi dhe e ka bashkuar me familjen e tij:

"Pse ai qe ruhet dhe ben durim, s'ka dyshim, Allahu nuk e humb shperblimin e punemireve." (Jusuf, 90)

Takua ben qe besimtari te fitoje udhezim.

"Elif, Lam, Mim. Ky eshte libri ne te cilin nuk ka dyshim. Udhezues per ata qe frikesohen (nga All-Ilahu). Ata te cilet e besojne te fshehten, e kryejne faljen dhe prej asaj qe Ne i kemi furnizuar, japist. Dhe ata te cilet e besojne ate qe t'u shpall Ty, dhe ate qe eshte shpallur para teje, dhe te cilet per ahiretin

(boten tjeter) jane te bindur. Te tillet jane te udhezuarit nga Zoti i tyre dhe te tillet jane te shpetuarit."
(Bekare, 1~5)

PERFITIMI QE KA BESIMTARI NE AKHIRET PER SHKAK TE FRIKES NDAJ ALLAHUT

Takua ben qe besimtari te behet fisnik para Allahut.

"Me te vertete me te ndershmit e fisniket tek ju para Allahut, jane ata qe kane takua."

(Huxhurat, 13)

Takua ben qe besimtari te jetë i suksesshem.

"E kush i bindet Allahut dhe te Derguari te Tij dhe ka ndroje Allahun dhe e ka frike Ate, ata jane te sukseshmit." (Nur, 52)

Me te vertete *takua* ben qe besimtari te shpetoje nga denimi i Allahut, me te Lartit, ne diten e gjykimit.

"Dhe nuk ka asnje nga ju veçse do te kaloje siper tij (xhehennemit). Kjo eshte nje e caktuar qe duhet te plotesohet. Pastaj Ai do t'i shpetoje ata qe e kishin frike Allahun dhe do t'i lejme zullumqaret aty te gjunjezuar." (Mejrem, 71-72)

"Do te largohen prej tij (xhehennemit) ata qe paten takua." (Lejl, 17)

Takua ben qe te pranohen veprat e mira te besimtarit.

"Me te vertete Allahu pranon vetem prej atyre qe kane takua." (Maide, 27)

Takua ben qe besimtari te fitoje xhennetin.

"Ato jane Xhennetet qe do t'ua trashegojme roberve Tane qe jane ruajtur." (Mejrem, 63)

Me te vertete *takua* ben qe besimtari te kete dhoma ne xhennet, njera siper tjetres.

"Nderkaq, ata qe u ruajten per hir te Zotit te tyre, per ta do te kete dhoma te ndertuara njera mbi tjetren, nen te cilat rrjedhin lumenjte. (Ky eshte) Premtimi i All-Ilahut, e All-Ilahu nuk e thyen premtimin." (Zumer, 20)

Ka nje hadith qe thote:"Me te vertete ne xhennet ka dhoma ne te cilat shihet pjesa e perparme nga prapa dhe pjesa e mbrapme nga perpara. Nje beduin pyeti:'Per ke jane keto, o i derguari i Allahut?' Ai, salAllahu alejhi ue selem, tha:'Per ate qe ka te folur te kendshem, qe ushqen nevojtarin, dhe fal namazin

e nates kur njerezit jane duke fjetur." (Sunen et Tirmidhi)

Takua ben qe besintari te kete grade te larte ne krahasim me pabesintaret ne doiten e gjykit, dhe ata do te jene banore te xhenneteve me te larta.

"Atyre qe nuk besuan, u eshte bere e hijshmejeta e kesaj bote dhe bejne tallje me ata qe besuan. Po ata qe u ruajten (besintaret) ne diten e kijametit, All-llahu u jep (shperblim) pa mase atij qe e do." (Bekare, 212)

Takua ben qe ata te hyjne ne xhennet, dhe kjo eshte sepse xhenneti eshte perqatitur per ata qe kane *takua*.

"Dhe ngutuni (me pune qe meriton) ne falje mekatesh nga Zoti juaj dhe per ne nje Xhennet, gjerlesia e te cilid eshte si gjerlesia e

qiejve dhe e tokes, i pergatitur per te devotshmit." (Ali Imran, 133)

"Sikur ithtaret e librit te besonin dhe te ruheshin, Ne do t'ua shlyenim mekatet e tyre dhe do t'i fusnim ne Xhennete te begatshme." (Maide, 65)

Takua ben qe te fshihen veprat e keqia dhe falja e gabimeve te besimtarit.

"Ky eshte vendim i All-llahut qe ua zbriti juve, e kush e ka frike All-llahun, Ai atij ia shlyen te keqijat dhe ia shton shperblimin." (Talak, 5)

"Sikur ithtaret e librit te besonin dhe te ruheshin (haramit), Ne do t'ua shlyenim mekatet e tyre dhe do t'i fusnim ne Xhennete me perjetime te begata." (Maide, 65)

Takua ben qe besimtari te kete çfare i do zemra e syte.

"Ështe Xhenneti i Adnit, ku do te hyjne. Nen te rrjedhin lumenj. Aty kane çka te deshirojne. Keshtu i shperblen All-llahu te ruajturit."
(Nahl, 31)

Takua ben qe besimtari te mos kete frike e as mos te deshperohet, dhe e keqja nuk do te bie mbi te ne diten e gjykimit.

"Ndersa All-llahu do t'i shpetoje me ate suksesin e tyre ata qe kishin qene te ruajtur. Ata nuk do t'i kape e keqja e as nuk do te jene te shqetesuar." (Zumer, 61)

"A nuk jane vertet eulijate (te dashurit) e All-llahut pa frike e brengosje? Ata te cilet besuan dhe ishin (prej atyre) qe frikesoheshin."

(Junus, 62-63)

Do te grumbullohen ne diten e gjykimit si te ftuar, dhe kuptimi i *u'wafdan*/te ftuar eshte se do te shkojne besintaret tek Allahu.

"Diten kur do t'i tubojme te devotshmit te i Gjithemeshirshmi si musafire te ftuar." (Mejrem, 85)

Ibn Kethiri tha duke permendur nje hadith nga Nu'man bin Sa'id, ku ai tha: "Ishim ulur me Aliun, radiAllahu anhu, kur ai recitoi ajetin: *"Diten kur do t'i tubojme te devotshmit te i Gjithemeshirshmi si musafire te ftuar."* (Mejrem, 85)

Ai tha: "Jo, pasha Allahun, ata nuk do te grumbullohen ne kembet e tyre. Te ftuarit nuk do te jene ne kembe, por ne nje deve, deve te cilat nuk jane pare me pare, te cilat do ta kene samarin (shalen) prej floriri. Do te hipin ne to derisa te trokasin

ne dyert e xhennetit."

Xhenneti do t'u afrohet atyre qe kishin *takua*.

"Dhe xhenneti do t'u sillet afer atyre qe kishin takua." (Shu'ara, 90)

Takua ben qe besimtari te mos jete ne te njejtin nivel si mekataret kriminele e kafirat.

"A mos do t'i barazojme ata qe besuan dhe bene vepra te mira me ata qe bene shkatterrime ne toke? Apo do t'i konsiderojne njesoj si te ruajturit prej te keqiave, si ata qe jane mekatare?" (Saad, 28)

Çdo shoqeri qe ka qene jo per hir te Allahut, do te kthehet ne armiqesi ne diten e gjykimit, perveç per shoquerine e atyre qe kane patur *takua*.

*"Shoket do te jene armiq ate dite,
perveç atyre qe kishin takua."*
(Zukhruf, 67)

Ata do te jene ne vende te sigurta
ne mes te kopshteve e burimeve.

*"Vertet, ata qe i paten frike Zotit,
jane ne vende te qeta. Jane ne
Xhennete e ne burime qe rrjedhin.
Veshin petka nga mendafshi e
kadifeja, ulur balle per balle. Ja,
keshtu, edhe i martoyme me
bardhoshe symedha (me hyrija). Aty
kerkojne t'u sillen çdo lloj peme dhe
aty jane te sigurt. Aty nuk do te
perjetojne vdekjen, perveç asaj te
pares ne dunja. Ata i shpetoi (All-
llahu) prej vuajtjeve te
Xhehennemit."* (Dukhan, 51-56)

Me te vertete *takua* ben qe te
kihet nje pozite e kenaqshme afer
Mbretit te Plotefuqishem, Allahut,
me te Lartit.

"Ne nje vend te kenaqshem afer Mbretit te Plotefuqishem." (Kamer, 55)

Takua eshte arsye per pasjen e lumenjeve te ndryshem ne xhennet; nje me uje te embel, nje tjeter me qumesht, shija e te cilit nuk ndryshon; nje prej vere, e mire per ata qe e pijne.

"A eshte Xheneti, i cili u eshte premtuar atyre qe jane ruajtur (te devotshem) ~ ne te cilin ka lumenj me uje per pije, lumenj nga qumeshti me shije te paprishur, lumenj nga vera e shijshme per njerez, lumenj nga mjalti i kulluar, dhe aty kane edhe gjithfare lloj pemesh, kane edhe falje nga Zoti i tyre ~ a eshte kjo njejte sikur vuajtja..." (Muhammed, 15)

Ne nje hadith ne Sahihul Bukhari, ne te cilin Profeti, salAllahu alejhi

ue selem, tha:"Kur te kerkoni prej Allahut, me te Lartit, kerkoni el Firdeus, sepse eshte ne mes te xhennetit e pjesa me e larte, prej nga burojne lumenjte dhe siper tij eshte Arshi i er-Rrahmanit."

Takua ben qe besintari te udhetoje ne hijet e pemeve ne xhennet, dhe te gjeje rehati ne keto hije.

"Dhe, nuk ka dyshim se te devotshmit do te jene nen hije prane burimeve, dhe kane peme çfare te deshirojne. Hani e pini shijshem e me endje, per ate e keni vepruar."
(Murselat, 41-43)

Enes ibn Malik, radiAllahu anhu, tha:"I derguari i Allahut, salaAllahu alejhi ue selem, tha:'Me te vertete ne xhennet eshte nje peme, ne te cilen kaloresi udheton per 100 vjet dhe nuk e kalon dot.'" (Bukhari)

Per ata qe kane *takua*, ne diten e gjykimit do te kete lajme te mira, tmerri i madh nuk do t'i deshperoje ata dhe engjejt do t'i takojne ata.

"Me te vertete eulijate (te dashurit) e All-llahut jane pa frike e brengosje, te cilet besuan dhe ishin (prej atyre) qe frikesoheshin. Atyre u jepen myzhde ne jeten e dunjase dhe ne jeten tjeter (per shpetim ne Xhennet). Nuk ndryshojne fjalet e All- llahut. E, ai eshte suksesi i madh". (Junus, 62~64)

Ibn Kethiri tha: "Persa i perket lajmit te mire ne diten e gjykimit, kjo eshte çfare Allahu ka thene: *"Ata nuk do t'i shqetesojë ajo frika e madhe (e fyterjes se Surit), dhe do t'i presin engjejt (duke u uruar):Kjo eshte dita e juaj qe ju premtohej."*"

(Enbija, 103)

Me te vertete ata qe kane *takua*,
do te kene nje shtepi me te mire ne
boten tjeter.

*"Atyre qe paten frike nga (denimi)
All-llahu, u thuhet:"* Ç'eshte ajo qe
shpalli Zoti juaj? Ata thoshin:
Shpalli çdo te mire! Ata qe bene
vepra te mira, edhe ne kete jete
kane shperblim te mire, por
shperblimi i tyre ne boten tjeter
eshte shume me i mire, e sa vend i
mire eshte ai i te devotshmeve."

(Nahl, 30)

Me te vertete atyre qe paten *takua*, do t'u shtohet shperblimi dhe
punet e mira, ashtu siç Allahu, me i
larti, ka thene:

*"O ju qe keni besuar, kini frike
All-llahun dhe vazhdoni me besim
ndaj te derguarit te Tij, se Ai ju jep
dyfish nga meshira e tij, ju dhuron*

drite qe ecni me te, ju fale mekatet tuaja. All-llahu eshte mekatfales, meshirues." (Hadid, 28)

E lusim Allahun, te Plotefuqishmin, te Madherueshmin, te na beje ne nga ata rober qe kane *takua* e jane falenderues. Te gjitha falenderimet i takojne Allahut, Zotit te boterave. Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi Profetin tone, Muhammedin, familjen e tij dhe shoket e tij.